Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0591

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "PROGLOBAL SH.P.K.", kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të "POLICIA E KOSOVËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-825-2-2-1, me 06/10/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "PROGLOBAL" SH.P.K. me Nr. 2023/0591 e datës 17/08/2023, kurse vendimi i AK "POLICIA E KOSOVËS" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-825-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i tarifave të ankesave në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrojnë kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.02.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-825-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 59,884.20 €.

Me 02.08.2023, AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme.

Me 04.08.2023, OE "PROGLOBAL"SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të cituar si më sipër. Me 08.08.2023, AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE" PROGLOBAL" SH.P.K.. me Nr.Protokolli 591/23, lidhur me aktivitetin "*Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së*" me numër të prokurimit 214-23-825-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmbanë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 591/23, ndërsa me datë 22/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me Nr. Protokoll 2023/0591 me rekomandimet si në vijim:

- OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. OE PROGLOBAL SH.P.K. nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa AK me 28.08.2023 ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Me datë 22.09.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e palëve procedurale si dhe eksperti shqyrtues.

Përfaqësuesi i palës ankuese gjatë seancës për shqyrtimi kryesor është deklaruar se qëndron prapa pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën me Nr të protokollit 591/2023 të dates 17.08.2023 duke shtuar se arsyetimi i AK për eliminimin e ofertës sonë, nuk është i bazuar në

fakte dhe argumente ngase në pyetje ka qenë "një shenjë e aparatit zjarrfikës" jo produkti apo "aprarati i zjarrfikjes" që konsiderohet element qenësor për këtë aktivitet, në ofertë kemi dorëzuar deklaratën e aneksit 1 për specifikime teknike duke përfshirë edhe katalogun e prodhuesit. Po ashtu me 04 maj 2023, prodhuesi përmes emalit ka konfirmuar për ne se e prodhon shenjen e njëjtë me dimensionin e njëjtë të shenjës qysh është kërkuar (prove kjo e prezantuar për AK). Gjithashtu me 25 korrik 2023 nga presidenti i kompanisë Eme ITALI kemi pranuar sërish deklaratën si konfirmim se prodhohet shenja që është kërkuar në dosjen e tenderit, një konfirmim i tillë ju është pepërcjelldhe PK në cilësinë e AK. AK e ka vënë në diskutim një gabim teknik të lëshuar nga prodhuesi I cili ne vend të vitit 2023 ka shënuar vitin 2022, I cili gabim me kërkesë tone na është ridërguar sërish nga prodhuesi e të cilin në dëshmi të proves e kemi sjellur edhe sot në seance dhe të njëjtën po e ddorëzojmë sqarojmë se prodhuesi EME nga Italia përveç aparateve të zjarrfikësve pjesëve e tjera prodhon edhe me dhjetëra shenja të ngjashme dhe me dimensione të ndryshme ndërsa që madhësia e dimensioneve është lehtësisht e realizueshme varësisht nga kërkesa e klientit. Pra, theksojmë për panelin shqyrtues se "shenja e aparatit zjarrfikës" e cila është kërkuar në dosjen e tenderit është artikulli me i thjeshtë në këtë aktivitet, dhe se shenja të tilla prodhohen edhe në shtypshkronja tek ne pa asnjë problem ne kemi sjellur si dëshmi edhe një të tillë për panelin në séance. Andaj ne vlerësojmë se pa të drejtë jemi eliminuar nga AK ngase është keqinterpretuar përgjigja e prodhuesit lidhur pyetjen e parashtruar për produktin 'shenjë" ku prodhuesit në shkresën e tyre kanë pohuar se momentalisht nuk e disponojnë në këtë madhësi andaj kjo lehtë mund të vërtetohet nga çdo pale se nuk bëhet fjalë qe i njëjti nuk mund të prodhohet nga ta apo është "jo ekzistent" siq e ka keqinterpretuar Policia e Kosovës, por se nuk e kanë të njëjtin të disponueshëm momentalisht, andaj me qëllim të sqarimit të kësaj çeshtje ne kemi bashkangjitur sërish konfimimim nga Prodhuesi "Emme Antincendio srl" të datës 25.07.2023, ku të njëjtit kanë konfirmuar edhe një herë që "*kjo shenjë do të prodhohet sipas porosisë së klientit duke përfshirë materialet dhe dimensione*", po ashtu prodhuesit kanë cekur dhe sqaruar për AK se përditësimi i katalogut në website nuk është i përhershëm, gjë që lë të nënkuptohet se mund të ndryshoj varësisht nga prodhimet e tyre. Andaj përfundimisht kërkojmë nga paneli shqyrtues që ankesën tonë ta aprovoj si të bazuar dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim duke pasur parasysh edhe natyrën komplekse të këtij aktiviteti, ngase me vite të tëra afërsisht 2 (dy) vite AK nuk kanë në dispozicion "mjetet për fikjen e zjarrit të nevojshme dhe urgjente" dhe kjo përgjegjësi sigurisht që i adresohet AK "Policia e Kosovës" ngase të njëjtit pa kurrfarë baze ligjore e anulojnë këtë aktivitet të prokurimit.

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktues gjatë seancës për shqyrtimit kryesor, është deklaruar se qëndron prapa vendimit të AK të dates 08.08.2023, duke pohuar me tej se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në rivlerësim. Kjo për faktin se me datën 20.07.2023 kemi filluar komunikimin e parë me prodhuesin në lidhje me katalogun e dorëzuar. Prodhuesi EME nga Italia me 20.07.2023, na ka kthyer përgjigje që ky katalog është i prodhuar nga ana e tyre, me 21.07.2023, ne kemi komunikuar prapë me prodhuesin dhe kemi pyetur për artikullin nr.8 "shenjë e aparatit zjarrfikës" a prodhohen këto dimensione nga ana e juaj si prodhues. Me 21.07.2023, prodhuesi n aka kthyer përgjigje ku citon se " dimensioni 150 X 150" nuk është ekzistues, ndërsa ekzistojnë dimensione tjera. Me 24.07.2023, ne kemi kërkuar sqarime nga ana e OE për katalogun dhe me përgjigjen që kemi marr nga ana e prodhuesit me 26.07.2023, OE lidhur me këtë na njofton dhe procedon ne sistem një sqarimin ku deklaron se lidhur me katalogun nuk është bë përditësimi i të dhënave në web faqen e prodhuesit, OE po ashtu e bashkëngjit një konfirmim ku në brendi të tekstit figuron data 04.05.2023, ndërsa në fund e vulosur dhe e nënshkruar është 25.07.2022, po ashtu e ka bashkangjitur edhe një emal komunikimi me prodhuesin të datës 04.05.2023 dhe 26.07.2023, po atë ditë ne serish fillojmë komunikimet me prodhuesin EME, me pyetjen për prodhuesin për të sqaruar "deklaratën e ofruar

nga OE si konfirmim per produktet e ofertuar me datat e ofruara si më lartë, në të njëjtën shkresë e pyesim po ashtu se a prodhohet ky artikull apo nuk prodhohet, nga prodhuesi ne si AK kemi pranuar vetëm një përgjigje se PO prodhohet, kurse në lidhje me pyetjen rreth deklaratës nuk kemi marr përgjigje, në bazë të kësaj AK vendos që aktivitetin ta anuloj. Pra, janë dy persona që komunikojnë brenda prodhuesit që kanë përgjigje të ndryshme pikërisht nga prodhuesi ku presidenti i kompanisë na e konfirmon që nuk ekzistojnë, ndërsa herën e dytë ka kthyer përgjigje personi tjetër. Lidhur me këtë paneli shqyrtues pyet AK se a kanë qenë në dijeni (cc në emal) të dy personat e prodhuesit lidhur me komunikimin e zhvilluar ndërmjet ju në cilësinë e AK dhe prodhuesit, të dya palët pohojnë se po.

Eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se qëndron prapa të gjeturave dhe rekomandimeve të evidentuara në raportin e përgatitur – ekspertizën të dates 22.08.2023 duke shtuar me tej se është jo relevante për t'u anuluar i gjithë aktiviteti i prokurimit mbi këtë bazë për këtë lloj etiket që është e karakterit sekondare në raport me kërkesat dhe shërbimet që janë kërkuar në këtë aktivitet nga AK. Po ashtu siç u sqarua më sipër ekziston një keqkuptim nga ana e AK lidhur me imellen e pranuar nga prodhuesi i cili ka pohuar se produkti "150X150 Extinguisher-not available in this size" kjo d.t.th se të njëjtit nuk e kanë të disponueshëm në këtë madhësi dhe nuk bëhet fjalë qe i njëjti nuk mund të prodhohet nga ta apo është jo ekzistent siq e ka keqinterpretuar Policia e Kosovës. Ankuesi ka ofruar për AK deklaratën për specifikacion që do tis jell saktë sipas kërkesës së AK në dosjen e tenderit, ka ofruar konfimimin nga prodhuesi të dates 04.05.2023 dhe po ashtu edhe ri-konfimimn e prodhuesit të dates 25.07.2023, Po ashtu AK edhe vet e konfirmoj në këtë seancë se prodhuesi me datën 26.07.2023 e ka konfirmuar prodhimin e produktit ALUMINIM SIGN OFEXTINGUISHER me dimensione 150X150, prandaj për një lëshim teknik për vit 2022 në 2023 nuk mund dhe nuk do duhej të anulohet oferta e OE ankues sepse të njëjtat janë korrigjuar si të tilla nga prodhuesi dhe po ashtu janë prezantu si dëshmi edhe në këtë seancë. Andaj nga cilësia ime si ekspert i lëndës lidhur në këtë çështje vlerësoj se OE ankues ka ofruar prova bindëse mbi bazën e të cilave kam rekomanduar se ky aktivitet do duhej të kthehet në Rivlerësim. Aktiviteti i prokurimit e ka një qellim dhe është shumë me rendësi të trajtohet qëllimi, lënda dhe objekti i kontratës në fjalë, të respektohen dispozitat ligjore të LPP dhe RRPP me theks të veçantë neni 1 Qëllimi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, lidhur me këtë aktivitet paneli vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PROGLOBAL" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe vendimi paraprak lidhur me këtë aktivitet sipas të cilit lënda ishte kthyer në rivlerësim për verifikim të pretendimeve ankimore kundrejt të rekomanduarit dhe eliminimit të tij (nënkupto ankuesin) nga komisioni profesional i AK, ngase sipas bindjes së panelit nuk kishte prova bindëse dhe të argumentuara se të dy ofertuesin ishin të papërgjegjshëm për aktivitet ashtu siç kishe pohuar eksperti, po ashtu morri parasysh edhe pikat e eliminimit të OE ankues në vendimin e datës 08.08.2023, përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues

"PROGLOBAL" SH.P.K. mund të cilësohen si pjesërisht të bazuara për faktin se Oe Ankues ka prezantuar si dëshmi katalogun me produktin e ofruar nga prodhuesi, Email nga prodhuesi të datës 04.05.2023 i cili konfirmon se prodhon artikullin e ofertuar, Deklaratën-Konfirmimi (Confimation statment) e datës 25 korrik 2023, nga presidenti i kompanisë EMME (Alberto Mili) me anë të së cilës ri konfirmohen se do ta prodhojnë artikullin sipas kërkesës së OE Ankues, po ashtu Përgjigja ne emalin zyrtar të Policisë së Kosovës 26.07.2023 nga prodhuesi EMME-Itali me të cilën konfirmon se "artikulli i kontestuar 150X150" prodhohet nga Emme Itali. Tutje Përgjigjën në letrën standarde të OE Ankues të datës 26.07.2023, për AK i cili nën përgjegjësi morale, materiale dhe ligjore konfirmon se të dhënat e katalogut janë autentike dhe të njëjtat janë konfirmuara disa herë nga prodhuesi se janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet teknike te Ankneksi 1 te FDT.

Paneli pati parasysh edhe komunikimet e zhvilluara ndërmjet AK dhe Prodhuesit Ema të prezantuara si dëshmi në seancë nga AK, përgjigjjen e prodhuesit "EMA" të datës 21.07.2023, të cilës i referohet AK, në përmbajtjen e të cilës përdoret termi "not-available in this size", paneli sqaron se edhe po ti referohemi fjalorit zyrtar anglisht-shqip kjo shprehje "*not-available in this size*" përkthehet/nënkupton "*nuk është në dispozicion në këtë madhësi*", andaj paneli vlerëson se nga shprehja e till e prodhuesit nuk mund të aludohet se ky produkt nuk ka ekzistuar apo nuk është ekzistent në këtë madhësi apo se nuk prodhohet nga prodhuesi EMMA siç pretendon AK. Prodhuesi ka konfirmuar po ashtu me shkresën e datës 25.07.2023 se webfaqja e tij/saj "EMME Antincendio srl" nuk ishte përditësuar me katalogun e ri. Andaj rrjedhimisht mbi bazën e të lartcekurave dhe provave të administruara, Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar njoftimin e AK të datës 02.08.2023, për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "*Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së*" me numër të prokurimit 214-23-825-2-2-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim** duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit "*Servisimi, Rimbushja dhe Furnizimi me Aparate kundër zjarrit në objektet e PK-së*" .

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shoh ligji në mënyrë selektive andaj bazuar ne pretendimet ankimore dhe atë qe u përshkrua si me larte, psh vendosi qe kjo procedure e prokurimit te kthehet ne ri vlerësim me qellim që të trajtohen ne mënyrë te drejte kërkesat, kundrejt ofertave sipas dispozitave dhe parimeve te prokurimit publik ne fuqi.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Njëkohësisht e obligon Ak që gjatë rivlerësimit të ofertave të veproj konformë FDT dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejtë ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenit 7, 59.69 të LPP lidhur me nenit 40, te RRPP-së

Paneli shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh edhe nenin 59 paragrafi 4 se edhe nëse do të kishte lëshime të vogla eventuale, që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara me njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, për panelin shqyrtues do të konsideroheshin jo të rëndësishme në raport me interesin publik dhe fondet publike, e për të cilat fonde dhe burime publike, autoritet kontraktuese janë të obliguara ti përdorin në mënyrë

ekonomike.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siq parashihet në nenin 6 të LPP-ës, Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimin të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese ne Republikën e Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke respektuar dhe duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: